<p>vazhdueshme apo kufizimit të lirisë dhe si rezultat kanë pësuar traumë në atë shkallë sa të ketë ndikuar rëndë në gjendjen, sjelljen dhe personalitetin e viktimës.</p> <p>2.Vuajtja psikike nënkupton shqetësimin emocional, traumën psikologjike, ndjenjën e pashpresës e të pafuqisë, turpin, humbjen e kënaqësisë për jetë, dhe shqetësime tjera të natyrës psikologjike që rezultojnë si pasojë e veprës penale dhe mund të ndikojnë në aspektin emocional, njohës dhe sjelljen e personit. Vuajtja psikike do të përcaktohet duke marrë parasysh rrethanat e rastit, llojin e veprës penale, nivelin dhe kohëzgjatjen e shqetësimit si dhe faktorë tjerë relevant.</p> <p>3.Kompensimi sipas këtij neni jepet në shumë fikse prej 2,000 Euro.</p>	<p>liberty and as a result have suffered trauma to the extent that it has severely affected the victim's condition, behavior and personality.</p> <p>2. Mental suffering means emotional distress, psychological trauma, feelings of hopelessness and powerlessness, shame, loss of life satisfaction, and other disturbances of a psychological nature that result from the criminal offense and may affect the emotional, cognitive, and behavioral aspects of the person. Mental suffering will be determined taking into account the circumstances of the case, the type of criminal offense, the level and duration of the distress as well as other relevant factors.</p> <p>3. Compensation under this Article shall be awarded in a fixed amount of 2,000 Euros.</p>	<p>koje su posledično doživele traumu do te mere da je ona teško uticala na stanje, ponašanje i ličnost žrtve.</p> <p>2.Psihička patnja predstavlja emocionalnu uznemirenost, psihološku traumu, osećaj beznađa i bespomoćnosti, srama, gubitak životnog zadovoljstva i druge poremećaje psihološke prirode koji predstavljaju posledicu krivičnog dela i mogu uticati na emotivne, kognitivne i bihevioralne aspekte osobe. Psihička patnja se utvrđuje uzimajući u obzir okolnosti predmeta, vrstu krivičnog dela, nivo i trajanje uznemirenosti kao i druge relevantne faktore.</p> <p>3.Naknada se u skladu sa ovim članom isplaćuje u fiksnom iznosu od 2.000 evra.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Kompensimi për vuajtje psikike për humbjen e anëtarit të familjes</p> <p>1.Të drejtë kompensimi sipas këtij neni kanë anëtarët e familjes së viktimës së ndjerë.</p> <p>2.Kompensimi sipas këtij neni bëhet në pajtim me nenin 12, paragrafin 3 dhe nuk</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 Compensation for mental suffering due to loss of a family member</p> <p>1. According to this Article, the family members of the deceased victim have the right to compensation.</p> <p>2. Compensation under the present Article is granted pursuant to Article 12, paragraph 3</p>	<p style="text-align: center;">Član 14 Naknada za psihičku patnju zbog gubitka člana porodice</p> <p>1.Prema ovom članu, članovi porodice preminule žrtve imaju pravo na ovu naknadu.</p> <p>2.Naknada se prema ovom članu isplaćuje u skladu sa članom 12. stav 3. i ne može</p>

<p>mund të tejkaloj shumën prej 3,000 Euro në total për të gjithë anëtarët e familjes së viktimës.</p> <p style="text-align: center;">Neni 15 Kompensimi për humbjen e të drejtës në mbajtje</p> <p>1.Vartësit kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesë për kompensim për humbjen e të drejtës në mbajtje në ato raste kur mund të dokumentojnë se i ndjeri ka qenë kontribues në mbajtjen e familjes.</p> <p>2.Kompensimi sipas këtij neni jepet në pajtim me kategorizimin e lëndimeve dhe dëmtimeve sipas Nenit 11, paragrafi 3 i këtij ligji, dhe në asnjë rast nuk do të kalojë shumën maksimale prej tre mijë (3,000) Euro për të gjithë vartësit.</p> <p style="text-align: center;">Neni 16 Kompensimi i shpenzimeve të varrimit</p> <p>1.Anëtarët e familjes së viktimës së ndjerë kanë të drejtë në kompensim për shpenzimet e varrimit. Kompensim sipas këtij neni paguhet në shumë fikse prej një mijë (1,000) Euro.</p>	<p>and may not exceed the amount of 3,000 Euro in total for all family members of the victim.</p> <p style="text-align: center;">Article 15 Compensation for loss of the right to subsistence</p> <p>1. Dependents shall have the right to file for compensation application for the loss of the right to subsistence when they can document that the deceased was a contributor to the family subsistence.</p> <p>2. Compensation under the present Article shall be granted based on the categorization of injuries and damages according to Article 11, paragraph 3 of the present law, and shall in no case exceed a maximum amount of three thousand (3,000) Euros for all dependents.</p> <p style="text-align: center;">Article 16 Compensation of funeral expenses</p> <p>1. Family members of the deceased victim shall be entitled to compensation for funeral expenses. Compensation under the present Article shall be awarded in a fixed amount of (1,000) Euros.</p>	<p>premašiti iznos od ukupno 3.000 evra za sve članove porodice žrtve.</p> <p style="text-align: center;">Član 15 Naknada za gubitak starateljstva</p> <p>1.Izdržavana lica imaju pravo da podnesu zahtev za naknadu štete zbog gubitka prava na starateljstvo u onim slučajevima u kojima mogu da dokumentuju da je preminuli doprinosio izdržavanju porodice.</p> <p>2.Naknada se prema ovom članu isplaćuje u skladu sa kategorizacijom povreda i oštećenja prema članu 11. stav 3. ovog zakona i ni u kom slučaju ne sme da premaši maksimalni iznos od tri hiljade (3.000) evra za sva izdržavana lica.</p> <p style="text-align: center;">Član 16 Naknada pogrebnih troškova</p> <p>1.Članovi porodice preminule žrtve imaju pravo na naknadu troškova sahrane. Naknada se u skladu sa ovim članom isplaćuje u fiksnom iznosu od hiljadu (1.000) evra.</p>
--	---	---

<p>2.Kompensimi për shpenzimet nga paragrafi 1 mund të kërkohet si pjesë e kërkesës për kompensim të menjëhershëm ose të rregullt. Parashtruesi i kërkesës duhet të posedojë autorizimin e anëtarëve të tjerë të familjes për tërheqjen e këtij kompensimi.</p> <p>3.Përpos kompensimit të paraparë me paragrafin 1 të këtij neni parashtruesi i kërkesës mund të kërkojë edhe kompensim për shpenzimet e transportimit të kufomës së viktimës nga një shtet tjetër. Shpenzimet rreth këtij transporti duhen të jenë të dokumentuara.</p>	<p>2. Compensation for expenses from paragraph 1 may be claimed as part of the application for immediate or regular compensation. The applicant must possess the authorization of other family members to withdraw such compensation.</p> <p>3. In addition to the compensation provided for in paragraph 1 of the present Article, the Applicant may also request compensation for the costs of transportation of the victim's corps from another county. Expenses related to this transportation must be documented.</p>	<p>2.Naknada troškova iz stava 1. može se zahtevati kao deo zahteva za neposrednu ili redovnu naknadu. Podnosilac zahteva mora imati ovlašćenja ostalih članova porodice za preuzimanje ove naknade.</p> <p>3.Pored naknade predviđene u stavu 1. ovog člana, podnosilac zahteva može tražiti i naknadu troškova prevoza tela žrtve iz druge države. Troškovi ovog transporta moraju biti dokumentovani.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Kompensim për dëmtimin apo shkatërrimin e pajisjeve mjekësore</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Compensation for damage or destruction of medical equipment</p>	<p style="text-align: center;">Član 17 Naknada na ime štete ili uništenja medicinske opreme</p>
<p>1.Parashtruesi i kërkesës do të rimburohet për pajisjet mjekësore të domosdoshme për shëndetin e viktimës dhe të cilat pajisje janë dëmtuar si pasojë e veprës së dhunshme nga i cili ka rezultuar edhe dëmtimi i viktimës.</p> <p>2.Kompensimi sipas këtij neni nuk do të kalojë shumë maksimum prej tremijë (3,000) Euro.</p>	<p>1. The Applicant will be reimbursed for the medical equipment necessary for the health of the victim, which have been damaged as a result of the violent act that resulted in the injury of the victim.</p> <p>2. Compensation under the present Article shall not exceed the maximum amount of three thousand (3,000) Euros.</p>	<p>1.Podnosiocu zahteva će biti nadoknađena medicinska oprema neophodna za zdravlje žrtve koja je oštećena nasilnim činom koji je doveo do povrede žrtve.</p> <p>2.Naknada iz ovog člana ne može preći maksimalni iznos od tri hiljade (3.000) evra.</p>

<p style="text-align: center;">Neni 18 Rrethanat që ndikojnë në kompensim</p> <p>1.Kompensimi mund të zvogëlohet ose të refuzohet:</p> <p>1.1.në varësi të kontributit të viktimës në shkaktimin e dëmit apo në përkeqësimin e dëmtimit të shkaktuar;</p> <p>1.2.në varësi të sjelljes së viktimës para, gjatë ose pas veprës penale;</p> <p>1.3.në varësi të përfshirjes së viktimës në krimin e organizuar apo të anëtarësisë së tij në një organizatë që përfshihet në krim të dhunshëm;</p> <p>1.4.nëse dhënia e plotë apo e pjesshme e kompensimit do të ishte në kundërshtim me kuptimin e drejtësisë, moralin apo rendit publik.</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Circumstances affecting compensation</p> <p>1. Compensation may be reduced or rejected:</p> <p>1.1. depending on the victim's contribution to the damage caused or the deterioration of the damage caused;</p> <p>1.2. depending on the victim's behavior before, during or after the offense;</p> <p>1.3. depending on the involvement of the victim in organized crime or his/her affiliation in an organization involved in violent crime;</p> <p>1.4. if the granting of full or partial compensation would be contrary to the notion of justice, morality or public order.</p>	<p style="text-align: center;">Član 18 Okolnosti koje utiču na visinu naknade</p> <p>1.Naknada se može umanjiti ili odbiti:</p> <p>1.1.u zavisnosti od doprinosa žrtve u prouzrokovanoj šteti ili pogoršanju prouzrokovane štete;</p> <p>1.2.u zavisnosti od ponašanja žrtve pre, tokom ili posle krivičnog dela;</p> <p>1.3.u zavisnosti od umešanosti žrtve u organizovani kriminal ili članstva u organizaciji koja je umešana u nasilno krivično delo;</p> <p>1.4.ako bi dodeljivanje potpune ili delimične naknade bilo u suprotnosti sa značenjem pravde, morala ili javnog poretka.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Marrja parasysh e kompensimeve të tjera</p> <p>1.Shuma e kompensimit për një lloj të caktuar të dëmit sipas këtij ligji do të zvogëlohet për pjesën e shërbimeve të</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Consideration of other types of compensation</p> <p>1. The amount of compensation for a certain type of damage under the present law will be reduced for the part of services provided free</p>	<p style="text-align: center;">Član 19 Razmatranje drugih vidova naknade</p> <p>1.Iznos naknade za određenu vrstu štete prema ovom zakonu biće umanjen za deo usluga koje besplatno pokrivaju javne</p>

<p>mbuluara falas nga institucionet shëndetësore publike, dëmshpërblimin e pranuar nga kryesi, kompensimin e pranuar nga sigurimi shëndetësor publik apo privat; kompensimin nga fondet tjera publike, apo kompensimin e pranuar nga programet tjera të kompensimit brenda ose jashtë vendit nëse janë mbuluar në emër të të njëjtit dëm respektivisht nga e njëjta bazë.</p> <p>2.Në vendimin për kompensim Komisioni do të merr parasysh edhe cilindo dëmshpërblim të urdhëruar nga gjykata që vendos në çështjen penale për veprën për të cilin kërkohet kompensimi, përveç nëse ai dëmshpërblim nuk është paguar.</p> <p style="text-align: center;">Neni 20 Bartja e së drejtës në kompensim</p> <p>1.E drejta në paraqitjen e kërkesës për kompensim nuk bartet tek vartësit në rast të vdekjes së viktimës pas paraqitjes së kërkesës për kompensim.</p> <p>2.Përrjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, në rastet kur viktimat e krimet ka kërkuar kompensim për lëndimet që iu janë shkaktuar si pasojë e veprave të dhunshme, por në ndërkohë i njëjti vdes jo si pasojë e atyre lëndimeve, anëtarit i familjes së të</p>	<p>of charge by public health institutions, the restitution received by the offender, the compensation received by public or private health insurance; compensation from other public funds, or compensation received from victim compensation programs inside or outside the country if they are covered for the same damage respectively on the same basis.</p> <p>2. When issuing the decision for compensation, the Commission will also take into account any compensation ordered by the court that decides on the criminal case for the criminal offense for which compensation is requested, unless that compensation has not been paid.</p> <p style="text-align: center;">Article 20 Transfer of the right to compensation</p> <p>1. The right to file a compensation application shall not be transferred to dependents in an event of death of the victim after filing a compensation application.</p> <p>2. Except for cases from paragraph 1 of the present Article, when the victim of crime has requested compensation for injuries caused as a result of violent acts, but in the meantime the victim dies from other circumstances that are not a result of those injuries, family</p>	<p>zdravstvene ustanove, obeštećenje dobijeno od učinioca, obeštećenje dobijeno od javnog ili privatnog zdravstvenog osiguranja; ili kompenzaciju iz drugih javnih fondova, ili naknadu primljenu iz drugih programa za naknadu žrtava unutar ili izvan zemlje ako su pokriveni na ime iste štete, odnosno po istom osnovu.</p> <p>2.U odluci o naknadi štete, Komisija uzima u obzir i svaku naknadu koju odredi sud koji odlučuje u krivičnom predmetu za krivično delo za koje se traži naknada, osim ako ta naknada nije plaćena.</p> <p style="text-align: center;">Član 20 Prenos prava na naknadu</p> <p>1.Pravo na podnošenje zahteva za naknadu ne prenosi se na izdržavana lica u slučaju smrti žrtve nakon podnošenja zahteva za naknadu.</p> <p>2.Izuzetno od stava 1. ovog člana, u slučajevima kada je žrtva krivičnog dela tražila naknadu za povrede koje su joj nanete nasilnim delima, a u međuvremenu premine ali ne od posledica tih povreda, član porodice preminulog ima pravo na naknadu</p>
--	--	---

<p>ndjerit ka të drejtë në kompensim në rast të plotësimit kumulativ të kushteve të mëposhtme:</p> <p>2.1.nëse Komisioni para vdekjes së viktimës ka marrë vendimin përfundimtar për kompensim të viktimës për lëndim, por ende nuk është bërë transferi i shumës së kompensimit në llogarinë e viktimës, dhe;</p> <p>2.2.nëse anëtari i familjes ka qenë financiarisht i varur nga i ndjeri dhe nuk ka burime tjera të mbajtjes.</p>	<p>members of the deceased shall be entitled to compensation when the following conditions are met cumulatively:</p> <p>2.1. if before the death of the victim the Commission has made a final decision to compensate the victim for the injury, but the transfer of the amount of compensation to the victim's account has not yet been made, and;</p> <p>2.2. if the family member was financially dependent on the deceased and has no other sources of subsistence.</p>	<p>štete u slučaju da su ispunjeni sledeći kumulativni uslovi:</p> <p>2.1.ako je Komisija pre smrti žrtve donela konačnu odluku o naknadi štete žrtvi za povredu, ali još uvek nije prenet iznos naknade na račun žrtve, i;</p> <p>2.2.ako je član porodice finansijski zavisio od preminulog lica i nema drugih izvora za izdržavanje.</p>
<p>KREU III - AUTORITET KOMPETENTE</p> <p>Neni 21 Komisioni për kompensimin e viktimës së krimit</p> <p>1.Komisioni për kompensim të viktimave të krimit emërohet nga qeveria e Republikës së Kosovës me këtë përbërje:</p> <p>1.1.një (1) gjyqtar i Gjykatës Supreme, si kryetar i Komisionit, i</p>	<p>CHAPTER III - COMPETENT AUTHORITIES</p> <p>Article 21 Crime Victim Compensation Commission</p> <p>1. The Crime Victim Compensation Commission shall be appointed by the Government of the Republic of Kosovo and shall have the following composition:</p> <p>1.1. one (1) judge of the Supreme Court, as chairperson of the</p>	<p>GLAVA III - NADLEŽNI ORGANI</p> <p>Član 21 Komisija za naknadu štete žrtvama krivičnih dela</p> <p>1.Komisiju za naknadu štete žrtvama krivičnih dela imenuje Vlada Republike Kosovo u sledećem sastavu:</p> <p>1.1.jedan (1) sudija Vrhovnog suda, kao predsednik Komisije, na predlog</p>

<p>propozuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës;</p> <p>1.2.një (1) përfaqësues nga shoqëria civile me njohuri në fushën e mbrojtjes së viktimave, anëtar, i propozuar nga Ministri i Drejtësisë dhe përkrahjen e së paku 5 organizatave të shoqërisë civile në fushën e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të viktimave ;</p> <p>1.3.një (1) anëtar nga radhët e mjekëve të licencuar në fushën e psikiatrisë të propozuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës;</p> <p>1.4.Udhëheqësi i njësisë administrative të Komisionit, anëtarë pa të drejtë vote, Përgjegjës në mungesë të kuorumit, Udhëheqësi i njësisë ka të drejtën e votës.</p> <p>2.Mandati i anëtarëve të Komisionit është (3) tri vite. Mandati i kryetarit të Komisionit është katër (4) vite. Anëtarët e Komisionit mund të rizgjidhen edhe për një mandat shtesë.</p> <p>3.Përbërja e Komisionit do të ketë parasysh kuotën gjinore dhe etnike.</p>	<p>Commission, proposed by the Kosovo Judicial Council;</p> <p>1.2. one (1) civil society representative with expertise in the field of victim protection, member, nominated by the Minister of Justice that is supported by at least 5 civil society organizations in the field of human rights and victims' rights;</p> <p>1.3. one (1) member from the ranks of licensed physicians in the field of psychiatry proposed by the Kosovo Chamber of Physicians;</p> <p>1.4. Head of the administrative unit of the Commission, a member without the right to vote. Exceptionally, in absence of a quorum the Head of the unit shall have the right to vote.</p> <p>2. The term of office of Commission members shall be (3) three years. The term of office of the Commission Chairperson shall be four (4) years. Members of the Commission may be re-elected for an additional term.</p> <p>3. The composition of the Commission shall take into account the gender and ethnic quota.</p>	<p>Sudskog saveta Kosova;</p> <p>1.2.jedan (1) predstavnik civilnog društva sa stručnošću u oblasti zaštite žrtava, člana kojeg je predložio ministar pravde i koga podržava najmanje 5 organizacija civilnog društva u oblasti ljudskih prava i prava žrtava;</p> <p>1.3.jedan (1) član iz reda licenciranih lekara na polju psihijatrije, koga predlaže Lekarska komora Kosova;</p> <p>1.4.Šef administrativne jedinice Komisije, član bez prava glasa. Izuzetno, u nedostatku kvoruma, šef jedinice ima pravo glasa.</p> <p>2.Mandat članova Komisije traje (3) tri godine. Mandat predsednika Komisije traje četiri (4) godine. Članovi Komisije mogu da budu ponovo izabrani na još jedan mandat.</p> <p>3.Sastav Komisije uzimaće u obzir rodnu i etničku kvotu.</p>
--	---	--

<p align="center">Neni 22 Pushimi dhe shkarkimi nga funksioni i anëtarit të Komisionit</p>	<p align="center">Article 22 Dismissal and suspension of Commission members</p>	<p align="center">Član 22 Prestanak i razrešenje dužnosti članova Komisije</p>
<p>1.Anëtarëve të Komisionit u pushon funksioni i anëtarit me:</p> <p>1.1.vdekje;</p> <p>1.2.humbjen e zotësisë për veprim për më shumë se tre (3) muaj për shkak të arsyeve mjekësore të vërtetuara;</p> <p>1.3.dështimin e vazhdueshëm për të marrë pjesë në veprimtaritë e Komisionit për më shumë se tre (3) muaj;</p> <p>1.4.pushimin e statusit mbi të cilin bazohet caktimi si anëtar;</p> <p>1.5.skadimin e mandatit;</p> <p>1.6.dorëheqje duke informuar Komisionin me njoftim paraprak prej tridhjetë (30) ditësh.</p> <p>2.Anëtarët e Komisionit shkarkohen nga funksioni para skadimit të mandatit për të cilin është zgjedhë nëse veprimet e tij e bëjnë të padenjë ushtrimin e funksionit të anëtarit</p>	<p>1. The function of Commission members shall be terminated as a result of:</p> <p>1.1. death;</p> <p>1.2. loss of legal capacity for more than three (3) months due to proven medical reasons;</p> <p>1.3. consistent failure to participate in activities of the Commission for more than three (3) months;</p> <p>1.4. termination of the status on which the appointment as a member is based;</p> <p>1.5. expiration of the term of office;</p> <p>1.6. resignation by informing the Commission with prior notice of thirty (30) days.</p> <p>2. Commission members shall be dismissed from the function before the expiration of the term of office for which they have been elected, if their actions make them unsuitable</p>	<p>1.Članovima Komisije prestaje mandat članova:</p> <p>1.1.smrću;</p> <p>1.2.gubitkom poslovne sposobnosti na više od tri (3) meseca, iz potvrđenih medicinskih razloga;</p> <p>1.3.neprekidnim neučestvovanjem u aktivnostima Komisije više od tri (3) meseca;</p> <p>1.4.prekidom statusa na kome se zasniva članstvo;</p> <p>1.5.istekom mandata;</p> <p>1.6.ostavkom, dostavljanjem prethodnog obaveštenja Komisiji, u roku od trideset (30) dana.</p> <p>2.Članovi Komisije razrešavaju se funkcije pre isteka mandata na koji su izabrani ako svojim postupcima budu nedostojni da obavljaju funkciju člana Komisije u</p>

<p>të Komisionit në raste kur anëtari:</p> <p>2.1.kryen detyrat në Komision në mënyrë të pandërgjegjshme, dhe;</p> <p>2.2.dënohet për veprë penale.</p> <p>3.Nëse një vend në Komision lirohet para skadimit të mandatit të një anëtari, pozita e lirë plotësohet në të njëjtën mënyrë si për anëtarin të cilit i ka skaduar mandati.</p> <p style="text-align: center;">Neni 23 Kryerja e detyrave nga Komisioni</p> <p>1.Komisioni do të vendosë për kërkesat për kompensim në mbledhjet e thirrura nga Kryetari.</p> <p>2.Sipas nevojës Komisioni mund të intervistojë apo kërkojë raport me shkrim nga zyrtarë përkatës, të cilët kanë qenë të përfshirë gjatë procedurës penale në rast dhe mund të kenë njohuri për ndikimin e veprës në viktimën.</p> <p>3.Komisioni gjatë vendimmarrjes ka diskrecion si në vijim:</p>	<p>to exercise the function of a Commission member when they:</p> <p>2.1. perform duties in the Commission in an irresponsible manner, and;</p> <p>2.2. are convicted of a criminal offense.</p> <p>3. If a position in the Commission is vacated before the expiration of the term of office of a member, the vacant position shall be filled in the same manner as for the expired members.</p> <p style="text-align: center;">Article 23 Performing tasks by the Commission</p> <p>1. The commission shall decide on compensation applications during meetings convened by the chairman.</p> <p>2. If necessary, the Commission may interview or request a written report from relevant officials who have been involved in criminal proceedings in the case and may have knowledge of the impact of the criminal offense on the victim.</p> <p>3. The commission shall at its discretion decide about the following:</p>	<p>slučajevima kada član:</p> <p>2.1. nesavesno obavlja dužnosti u Komisiji, i;</p> <p>2.2.bude osuđen za krivično delo.</p> <p>3.Ako se mesto u Komisiji uprazni pre isteka mandata člana, upražnjeno mesto popunjava se na isti način kao za člana kojem je istekao mandat.</p> <p style="text-align: center;">Član 23 Obavljanje zadataka Komisije</p> <p>1.Komisija odlučuje o zahtevima za naknadu štete na sastancima koje saziva predsednik.</p> <p>2.Po potrebi, Komisija može obaviti razgovor ili zatražiti pisani izveštaj od nadležnih službenika koji su uključeni u krivični postupak u datom predmetu i mogu da imaju saznanja o uticaju krivičnog dela na žrtvu.</p> <p>3.Komisija tokom odlučivanja ima sledeće diskreciono pravo:</p>
--	--	---

<p>3.1. Tejkalimin e shumave maksimale siç parashihet për kategoritë e veçanta të kompensimit, në rastet kur shpenzimet e dokumentuara janë të arsyeshme.</p> <p>3.2. Caktimin e lartësisë së kompensimit sipas Nenit 8, paragrafi 2.2.2 dhe Nenit 11, paragrafi 5;</p> <p>3.3. Vazhdimin e afatit për dorëzim e kërkesës apo plotësimeve të kërkuara në rastet kur është qartësisht e arsyeshme se një vonesë e tillë ka qenë e pashmangshme.</p> <p>4. Anëtarëve të Komisionit për punën e tyre u takon e drejta në shpërblim në pajtim me vendimin e qeverisë.</p> <p>5. Komisioni do të miratojë rregulloren e punës për mënyrën e funksionimit të tij, rolin dhe detyrat e njësisë mbështetëse dhe komunikimin mes tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 24 Përgjashtimi dhe kundërshtimi</p> <p>Dispozitat e Ligjit të procedurës kontestimore të cilat vlejné për përgjashtimin</p>	<p>3.1. Exceeding the maximum amounts provided for the specific categories of compensation, in cases where the documented costs are reasonable.</p> <p>3.2. Determining the amount of compensation based on Article 8, paragraph 2.2.2 and Article 11, paragraph 5;</p> <p>3.3. Extension of the deadline for submission of the application or required additional documents in cases where it is clearly reasonable that such a delay has been unavoidable.</p> <p>4. Commission members shall be entitled to remuneration for their work in line with the decision of the government.</p> <p>5. The Commission shall adopt its rules of procedure regulating its manner of operation, the role and tasks of the Support Unit and the communication between them.</p> <p style="text-align: center;">Article 24 Disqualification and objection</p> <p>The provisions of the Law on Contested Procedure which apply to the disqualification</p>	<p>3.1. Prekoraçenje maksimalnih iznosa predviđenih za posebne kategorije naknada, u slučajevima kada su dokumentovani troškovi razumni.</p> <p>3.2. Utvrđivanje iznosa naknade prema članu 8, stav 2.2.2 i članu 11, stav 5;</p> <p>3.3. Produženje roka za podnošenje zahteva ili dopuna traženih u slučajevima kada je očigledno opravdano da je takvo zakašnjenje bilo neizbežno.</p> <p>4. Članovi Komisije za svoj rad ostvaruju pravo na naknadu u skladu sa odlukom vlade.</p> <p>5. Komisija usvaja pravilnik koji uređuje njen način funkcionisanja, ulogu i zadatke jedinice za podršku i njihovu međusobnu komunikaciju.</p> <p style="text-align: center;">Član 24 Izuzete i protivljenje</p> <p>Odredbe Zakona o parničnom postupku koje uređuju izuzete sudija analogno se</p>
--	---	---

<p>e gjyqtarëve janë të aplikueshme në mënyrë analoge edhe për anëtarët e Komisionit për kompensim.</p> <p style="text-align: center;">Neni 25 Mbështetja nga njësia administrative e Komisionit</p> <p>1.Ministria e Drejtësisë do të sigurojë mbështetjen administrative-teknike për Komisionin (tutje: Njësia).</p> <p>2.Njësia është përgjegjëse për pranimin dhe shqyrtimin paraprak të kërkesave si në vijim:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.Nëse kërkesa është dorëzuar në afatin e përcaktuar me Ligj .</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2 Nëse kërkesa përmban ndonjë mangësi, është e pakompletuar apo e pakuptueshme.</p> <p>3. Nëse kërkesa është e pasafatshme, Njësia e njofton Kryetarin e Komisionit dhe parashtruesin për refuzimin e kërkesës.</p> <p>4.Në rastet nga paragrafi 2.2., Njësia komunikon me parashtruesit e kërkesave për tu kërkuar të dhënat shtesë dhe korrigjimet e nevojshme. Afati i përcaktuar për</p>	<p>of judges shall analogously apply to the members of the Compensation Commission.</p> <p style="text-align: center;">Article 25 Support by the Commission’s Administrative Unit</p> <p>1. The Ministry of Justice shall provide administrative-technical support to the Commission (hereinafter: The Unit).</p> <p>2. The Unit shall be responsible to receive and conduct preliminary review of applications as follows:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1.If the request was submitted within the deadline provided by law.</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2. If the application contains deficiencies, is incomplete or incomprehensible.</p> <p>3. If the request is submitted after the deadline, the Unit shall notify the Chairperson of the Commission and the applicant of the application rejection.</p> <p>4. In cases from paragraph 2.2, the Unit shall communicate with applicants to request additional data and necessary corrections. The deadline for correcting a deficiency of an</p>	<p>primenjuju i na članove Komisije za naknadu štete.</p> <p style="text-align: center;">Član 25 Podrška administrativne jedinice Komisije</p> <p>1. Ministarstvo pravde obezbeđuje administrativno-tehničku podršku Komisiji (u daljem tekstu: Jedinica).</p> <p>2. Jedinica je odgovorna za prijem i prethodno razmatranje zahteva na sledeći način:</p> <p style="padding-left: 40px;">2.1 Da li je zahtev podnet u zakonom propisanom roku.</p> <p style="padding-left: 40px;">2.2 Da li zahtev sadrži nedostatke, nepotpun je ili nerazumljiv.</p> <p>3. Ako je zahtev podnet nakon roka, Jedinica obaveštava predsednika Komisije i podnosioca zahteva o odbijanju zahteva.</p> <p>4. U slučajevima navedenim u stavu 2.2, Jedinica stupa u kontakt sa podnosiocima zahteva kako bi zatražila dodatne podatke i potrebne ispravke. Rok za otklanjanje</p>
---	--	---

<p>korrigjimin e një mangësie në një kërkesë të pakompletuar dhe të pakuptueshme nuk duhet të jetë më i shkurtër se tridhjetë (30) ditë. Nëse kërkesa nuk plotësohet edhe pas afatit shtesë. Nëse kërkesa nuk plotësohet edhe pas afatit shtesë, Komisioni merr vendim për rastin.</p> <p>5.Njësia pas shqyrtimit paraprak të kërkesës, mund të udhëzojë parashtruesin se në bazë të dokumentacionit të prezantuar, i njëjti mund të bëj plotësimin e kërkesës duke aplikuar edhe për kategorinë përkatëse të kompensimit për shqyrtim nga Komisioni.</p> <p>6. Njësia është përgjegjëse edhe për komunikimin me autoritetet kompetente për sigurimin e informatave të nevojshme.</p> <p>7. Detyrat dhe përgjegjësitë e veçanta të Njesisë përcaktohen me Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të Ministrisë së Drejtësisë.</p>	<p>incomplete and incomprehensible application shall not be less than thirty (30) days. If the request is not completed even after the additional deadline, the Commission shall render a decision on the case.</p> <p>5. After the preliminary review of the application the Unit can instruct the applicant, based on the submitted documentation, that he/she can complete the claim by applying for the relevant category of compensation subject to review by the Commission.</p> <p>6. The unit shall also be responsible for communicating with the competent authorities to obtain the necessary information.</p> <p>7. The special duties and responsibilities of the Unit shall be defined by the Regulation on the internal organization and systematization of jobs of the Ministry of Justice.</p>	<p>nedostataka u nepotpunom i nerazumljivom zahtevu ne sme biti kraći od trideset (30) dana. Ako zahtev nije upotpunjen ni nakon dodatnog roka, Komisija donosi odluku o slučaju.</p> <p>5. Jedinica nakon preliminarnog razmatranja zahteva može uputiti podnosioca zahteva da na osnovu dostavljene dokumentacije dopuni zahtev tako što će podneti zahtev za odgovarajuću kategoriju naknade za razmatranje Komisiji.</p> <p>6. Jedinica je takođe odgovorna za komunikaciju sa nadležnim organima radi dobijanja potrebnih informacija.</p> <p>7. Posebne dužnosti i odgovornosti Jedinice propisane su Pravilnikom o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta Ministarstva pravde.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 26 Obligimi për të siguruar informata</p> <p>1.Secili institucion i cili bie në kontakt me viktimën, ka për obligim të informojë atë</p>	<p style="text-align: center;">Article 26 Obligation to provide information</p> <p>1. Every institution that comes into contact with the victim, shall have the obligation to</p>	<p style="text-align: center;">Član 26 Obaveza pružanja informacija</p> <p>1.Svaka institucija koja dođe u kontakt sa žrtvom dužna je da je obavesti o njenom</p>

<p>për të drejtën në kompensim sipas këtij ligji.</p> <p>2.Ministria e Drejtësisë do të publikojë në faqen e saj të internetit informatat e nevojshme për të kërkuar kompensim, formularët për paraqitje të kërkesës dhe udhëzimet tjera të nevojshme për të gjitha situatat vendore dhe ndërkufitare. Ministria e Drejtësisë do të bëjë publike informacione në lidhje me programin për kompensim. . Të gjitha informatat do të publikohen në pajtim me Ligjin për përdorimin e gjuhëve si dhe në gjuhën angleze.</p> <p>3.Ministria e Drejtësisë në rast nevojë, do të ofrojë udhëzime të përgjithshme për parashtruesit e kërkesës. Udhëzimet do të përfshijnë informatat se si do të plotësohet aplikacioni dhe çfarë dokumentacioni mbështetës mund të jetë i nevojshëm.</p> <p>4.Ministria e Drejtësisë, kurdo që është e nevojshme, do të sigurojë shkëmbimin e informatave me autoritetet kompetente të shteteve tjera, sipas rregulloreve të shteteve përkatëse kompetente për kryerje të detyrave në procedurat e kompensimit të kërkesave. Ministria e Drejtësisë do të ofrojë asistencë dhe të kërkojë zgjidhje adekuate lidhur me zbatimin e dispozitave në situatat ndërkufitare.</p>	<p>inform him/her about the right to compensation under the present law.</p> <p>2. The Ministry of Justice shall publish the necessary information on how to apply for compensation, application forms and other necessary instructions on its website for all domestic and cross-border situations. The Ministry of Justice shall publish information about the compensation program. All information shall be published in line with the Law on the use of languages and in English.</p> <p>3. If necessary the Ministry of Justice, will provide general instructions to the applicants. The instructions will include information on how to complete the application and what supporting documentation may be needed.</p> <p>4. Whenever necessary the Ministry of Justice shall ensure the exchange of information with the competent authorities of other countries, competent for performing duties in compensation application procedures, in line with the regulations of the respective countries. The Ministry of Justice shall provide assistance and seek adequate solutions regarding implementation of provisions in cross-border situations.</p>	<p>pravu na naknadu štete prema ovom zakonu.</p> <p>2.Ministarstvo pravde na svojoj internet stranici objavljuje informacije potrebne za zahtevanje naknade, obrasce zahteva i druga potrebna uputstva za sve domaće i prekogranične slučajeve. Ministarstvo pravde objavljuje informacije o programu naknade. Sve informacije objavljuju se u skladu sa Zakonom o upotrebi jezika i na engleskom jeziku.</p> <p>3.Ministarstvo pravde, ako je potrebno, daje opšta uputstva podnosiocima zahteva. Uputstva će sadržati informacije o tome kako popuniti zahtev i koja je prateća dokumentacija potrebna.</p> <p>4.Ministarstvo pravde, kad god je potrebno, obezbeđuje razmenu podatka sa nadležnim organima drugih država, u skladu sa propisima odgovarajućih država nadležnih za postupanje po zahtevima za naknadu štete. Ministarstvo pravde pruža pomoć i traži odgovarajuća rešenja u vezi sa primenom odredaba u prekograničnim slučajevima.</p>
---	--	---

<p>5.Me kërkesë të Komisionit, policia i siguron Komisionit të dhëna mbi veprën penale nga e cila pretendon se ka pësuar viktimë.</p> <p>6.Institucionet shëndetësore, sociale, policia, prokuroria, gjykatat dhe institucionet tjera të nivelit lokal dhe qendror duhet t'i vendosin në dispozicion në vende publike informata rreth programit të kompensimit.</p> <p>KREU IV - PROCEDURAT E KËRKIMIT TË KOMPENSIMIT</p> <p>Neni 27 Dorëzimi i kërkesës për kompensim</p> <p>1.Kërkesa për kompensim dorëzohet në Ministrinë e Drejtësisë, adresuar Njësisë përkatëse për mbështetje Komisionit për Kompensim të Viktimave të Krimin.</p> <p>2.Kërkesa e plotësuar së bashku me dokumentacionin përkatës dorëzohet në adresë të Komisionit për kompensim në Ministrinë e Drejtësisë në njërin nga mënyrat si më poshtë:</p> <p>2.1. drejtpërdrejtë</p> <p>2.2. me postë,</p>	<p>5. At the request of the Commission, the police shall provide data on the criminal offense from which the victim claims to have suffered.</p> <p>6. Healthcare and social institutions, police, prosecution, courts and institutions from local and central level should make information on Victim Compensation Program available in public places.</p> <p>CHAPTER IV - COMPENSATION APPLICATION PROCEDURES</p> <p>Article 27 Filing of compensation application:</p> <p>1. The compensation application shall be filed to the Ministry of Justice, addressed to the relevant Support Unit of the Crime Victim Compensation Commission.</p> <p>2. The completed application together with the relevant documentation shall be submitted to the address of the Compensation Commission in the Ministry of Justice in one of the following ways:</p> <p>2.1 in person</p> <p>2.2. by mail,</p>	<p>5.Na zahtev Komisije, policija Komisiji dostavlja informacije o krivičnom delu koje žrtva tvrdi da je pretrpela.</p> <p>6.Zdravstvene i socijalne ustanove, policija, tužilaštvo, sudovi i institucije lokalnog i centralnog nivoa dužni su da informacije o programu za naknadu žrtava učine dostupnim na javnim mestima.</p> <p>GLAVA IV - POSTUPCI ZA ZAHTEVANJE NAKNADE</p> <p>Član 27 Podnošenje zahteva za naknadu štete</p> <p>1.Zahtev za naknadu štete podnosi se Ministarstvu pravde, odnosno nadležnoj jedinici za podršku Komisije za naknadu štete žrtvama krivičnih dela.</p> <p>2.Popunjen zahtev se zajedno sa pratećom dokumentacijom podnosi na adresu Komisije za naknadu štete u Ministarstvu pravde na jedan od sledećih načina:</p> <p>2.1 lično</p> <p>2.2 poštom</p>
--	---	--

<p>2.3.me postë elektronike (e-mail).</p> <p>3.Për plotësimin e kërkesës për kompensim, viktimat e krimit mund të kërkojnë ndihmën e mbrojtësit të viktimave apo organizatave joqeveritare që ofrojnë ndihmë juridike falas për viktimat.</p> <p>4.Në rast të angazhimit të avokatit privat për plotësimin dhe dorëzimin e kërkesës për kompensim, Komisioni nuk do të kompensojë parashtruesin e kërkesës për tarifën e kërkuar nga avokati privat.</p> <p>5.Komisioni, në pajtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, mund të shqyrtojë edhe kërkesat për kompensim të referuara nga Gjykata.</p> <p>6.Parashtresat në procedurat e kompensimit janë të përjashtuara nga çdo tarifë.</p> <p>7.Ministria e Drejtësisë do të përgatisë formularët standard të kërkesës për kompensim nga nenet 8, 9 dhe 34 i këtij Ligji.</p> <p>8.Viktima e krimit do të jep pëlqim për procesim të të dhënave personale përkatëse dhe të dhënat e ndjeshme personale për</p>	<p>2.3. by e-mail.</p> <p>3. The crime victim may seek the assistance of a victim advocate or non-governmental organizations that provide free legal aid to victims, in completing the compensation application.</p> <p>4. In cases where a private attorney is hired to complete and submit compensation application, the Commission will not compensate the fee requested by the private attorney.</p> <p>5. The Commission may also consider compensation applications referred by the Court, in line with the provisions of the Criminal Procedure Code.</p> <p>6. Submissions in compensation proceedings shall be exempt from any fees.</p> <p>7. The Ministry of Justice will prepare standard compensation application forms based on Articles 8, 9 and 34 of the present Law.</p> <p>8. The crime victim shall give consent for processing of relevant personal data and sensitive personal data for the purpose of</p>	<p>2.3.putem elektronske pošte (imejlo).</p> <p>3.Prilikom popunjavanja zahteva za naknadu štete, žrtva krivičnog dela može da zatraži pomoć zastupnika žrtve ili nevladinih organizacija koje pružaju besplatnu pravnu pomoć žrtvama.</p> <p>4.U slučaju angažovanja privatnog advokata za popunjavanje i podnošenje zahteva za naknadu štete, Komisija podnosiocu zahteva neće nadoknaditi naknadu koju u tu svrhu zahteva privatni advokat.</p> <p>5.Komisija, u skladu sa odredbama Zakonika o krivičnom postupku, takođe može da razmatra zahteve za naknadu štete koje joj uputi sud.</p> <p>6.Za podneske u postupcima naknade štete ne plaća se taksa.</p> <p>7.Ministarstvo pravde pripremiće standardne obrasce zahteva za naknadu štete iz članova 8, 9 i 34 ovog zakona.</p> <p>8.Žrtva krivičnog dela daje saglasnost za obradu relevantnih ličnih podataka i osetljivih ličnih podataka u svrhu procene</p>
---	--	---

<p>qëllim të vlerësimit të kërkesës për kompensim.</p> <p>9.Nëse viktimja e krimit është e penguar për të dhënë pëlqim për shkak të dëmtimit fizik apo psikik, konsiderohet se të drejtën e dhënies së një pëlqimi të tillë e ka përfaqësuesi ligjor i viktimës.</p> <p>10.Parashtruesi i kërkesës deklaron se nuk ka të drejtë të kërkojë kompensimin nga burime tjera.</p> <p>11.Vërtetësia e deklaratave në kërkesë i nënshtrohet dispozitave përkatëse që i referohen deklaratave të rremë të Kodit Penal.</p> <p>12.Kërkesa duhet të dorëzohet në gjuhën shqipe apo serbe për viktimat vendore, ndërkaq për situatat ndërkufitare vendore është i pranueshëm edhe versioni në gjuhën angleze.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Dokumentet që duhet bashkëngjitur kërkesës për kompensim</p> <p>1.Kërkesës së parashtruar në pajtim me nenin 8 të këtij Ligji i bashkëngjiten dokumentet në vijim:</p>	<p>assessing the compensation application.</p> <p>9. If the crime victim is prevented from giving consent due to physical or psychological injury, it shall be considered that the legal representative of the victim has the right to give such consent.</p> <p>10. The Applicant shall declare that he has no right to seek compensation from other sources.</p> <p>11. The veracity of the statements in the application shall be subject to relevant provisions of the Criminal Code referring to false declaration.</p> <p>12. The request must be submitted in Albanian or Serbian for local victims, while the English version is also admissible for domestic cross-border situations.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Documents to be attached to compensation application</p> <p>1. The following documents shall be attached to application submitted based on Article 8 of the present Law:</p>	<p>zahteva za naknadu štete.</p> <p>9.Ako je žrtva krivičnog dela sprečena da da saglasnost zbog fizičke ili psihičke povrede, smatra se da zakonski zastupnik žrtve ima pravo da da takvu saglasnost.</p> <p>10.Podnosilac zahteva izjavljuje da nema pravo da traži naknadu iz drugih izvora.</p> <p>11.Istinitost navoda u zahtevu podleže relevantnim odredbama Krivičnog zakonika koje se odnose na davanje lažne izjave.</p> <p>12.Zahtev se mora podneti na albanskom ili srpskom jeziku za domaće žrtve, dok je verzija na engleskom jeziku prihvatljiva i za prekogranične slučajeve.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Dokumenti koji se prilažu uz zahtev za naknadu štete</p> <p>1.Uz zahtevu podnet u skladu sa članom 8. ovog zakona prilažu se sledeći dokumenti:</p>
--	---	---

<p>1.1.Cfarëdo dokumenti të lëshuar nga policia i cili dokumenton se vepra penale është zbuluar, raportuar dhe trajtuar, përfshirë edhe cilësimin si viktimë e veprës penale.</p> <p>1.2.Dëshminë mbi gjendjen financiare të parashtruesit të kërkesës.</p> <p>2.Kërkesës së parashtruar në pajtim me paragrafët 1 deri 4 të nenit 9 të këtij ligji duhet t'i bashkëngjiten:</p> <p>2.1.Vendimi i plotfuqishëm.</p> <p>3.Kërkesës së parashtruar në pajtim me paragrafin 5 të nenit 9 të këtij ligji duhet t'i bashkëngjiten:</p> <p>3.1.Vendimi apo ndonjë dokument tjetër zyrtar i cili vërteton situatat nga paragrafi 5 i nenit 9;</p> <p>4.Përpos dokumenteve të specifikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, kërkesës së bashkëngjiten edhe dokumentet në vijim:</p> <p>4.1.Dokumentin e identifikimit. Në rast të një viktime të trafikimit, kur</p>	<p>1.1.Any document issued by the police which documents that the criminal offense was detected, reported and addressed that includes the qualification of the victim of the offense.</p> <p>1.2.Evidence on the financial situation of the Applicant.</p> <p>2. The following documents must be attached to application submitted based on paragraphs 1 to 4 of Article 9 of the present law:</p> <p>2.1.The final decision.</p> <p>3. The following documents must be attached to application submitted based on Article 9 par 5 of the present law:</p> <p>3.1 .Decision or any other official document which confirms situations from Article 5 par 9;</p> <p>4. In addition to documents specified in paragraphs 1, 2 and 3 of the present Article, the following documents shall be attached to the application:</p> <p>4.1. Identification document. In case of a victim of trafficking that does</p>	<p>1.1. Bilo koji dokument koji je izdala policija koji dokumentuje da je krivično delo otkriveno, prijavljeno i obrađeno i sadrži označenje žrtve krivičnog dela.</p> <p>1.2.Dokazi o finansijskoj situaciji podnosioca zahteva.</p> <p>2. Uz zahtev podnet u skladu sa stavovima 1 do 4 člana 9. ovog zakona mora da se priloži:</p> <p>2.1.Pravosnažno rešenje.</p> <p>3.Uz zahtev podnet u skladu sa stavom 5. člana 9. ovog zakona mora da se priloži:</p> <p>3.1. Rešenje ili bilo koji drugi zvanični dokument kojim se potvrđuju situacije iz stava 5 člana 9;</p> <p>4.Uz dokumente navedene u stavovima 1, 2 i 3 ovog člana, uz zahtev se prilažu i sledeći dokumenti:</p> <p>4.1.Lične isprave. U slučaju žrtve trgovine ljudima, kada žrtva ne</p>
---	--	--

<p>viktima nuk posedon dokumente identifikuese, identiteti i viktimës konstatohet në bazë të raportit të policisë respektivisht nga aktgjykimi i gjykatës kompetente që ka trajtuar çështjen penale.</p> <p>4.2.Autorizimi për parashtruesin e kërkesës në rastet kur ky person kërkon kompensimin në emër të viktimës apo vartësve të viktimës.</p> <p>4.3.Raportet përkatëse mjekësore dhe dokumentet apo prova tjera të besueshme që dëshmojnë që viktima e krimit ka pësuar lëndim trupor, dëmtim të shëndetit apo vuajtje, përpos rasteve nga paragrafi 2 i këtij neni;</p> <p>4.4.Dëshmitë e shpenzimeve kur ky dokumentim kërkohet sipas kategorisë së caktuar.</p> <p>4.5.Çertifikatën e bashkësisë familjare në rastet kur kërkesa për kompensim parashtrohet nga vartësit, respektivisht anëtarët e familjes së viktimës.</p> <p>4.6.Dokument që dëshmon që viktima ka qenë kontribues në</p>	<p>not possess identification documents, the identity of the victim shall be ascertained on the basis of the police report, respectively the judgment of the competent court that handled the criminal case.</p> <p>4.2. Authorization for the applicant where such he/she seeks compensation on behalf of the victim or victim's dependents.</p> <p>4.3. Relevant medical reports and other reliable documents or evidence proving that the crime victim has suffered a bodily injury, damage to health or suffering, except in cases referred to in paragraph 2 of the present Article;</p> <p>4.4. Evidence of expenses when such documentation is required based on the specific category.</p> <p>4.5. Certificate of family union in cases where the compensation application is submitted by dependents, respectively family members of the victim.</p> <p>4.6. Document proving that the victim contributed to family</p>	<p>poseduje lične isprave, identitet žrtve utvrđuje se na osnovu policijske prijave, odnosno presudom nadležnog suda koji je vodio krivični predmet.</p> <p>4.2.Punomoćje dato za podnosioca zahteva u slučajevima kada ovo lice traži naknadu u ime žrtve ili izdržavanih lica žrtve.</p> <p>4.3.Relevantni medicinski izveštaji i drugi verodostojni dokumenti ili dokazi koji dokazuju da je žrtva krivičnog dela pretrpela telesnu povredu, štetu po zdravlje ili patnju, osim u slučajevima predviđenim stavom 2 ovog člana;</p> <p>4.4.Dokazi o troškovima kada se takva dokumentacija traži prema određenoj kategoriji.</p> <p>4.5. Potvrda o porodičnoj zajednici u slučajevima kada zahtev za naknadu štete podnose izdržavana lica, odnosno članovi porodice žrtve.</p> <p>4.6.Dokument koji dokazuje da je žrtva doprinosila izdržavanju</p>
---	--	---

